



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE NOTERISE
Nr. 2851 Rep.Nr. 1126 Kol.

Taksa e punës u pagua

**KONTRATE DHURIMI KUOTASH
TE SHOQERISE "ALB-DRIL" SH.P.K**

Sot, më datën 20 Gusht 2019 (dymijë e nënëtmëbëdhjetë) përpara meje Noteres Amarda B. Shanaj, anëtare e Dhomës Lokale së Noterëve Vlore, me seli ne Fier, me adresë Rr. « Dervish Hekali » u par arqitën personalisht palët kontaktuese të cilët kërkuan redaktimin e kësaj kontrate Dhurimi Kuotash me termat e mëposhtme :

PALET NE KONTRATE

PALA DHURUESE:

Ermal Dogani, atesia Qemal dhe amesi Luljeta, i datelindjes 16.05.1990, lindur ne Fier dhe banues ne Njesia Administrative Zharrez, Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje Noteres, identifikuar prej leternjoftimit me nr.personal (ID) J00516035E dhe nr. 028918540 ne cilesine e Ortakut themelues te shoqerise "ALB-DRIL" sh.p.k, pronar dhe zotërues i 1 kuote me pjesmarrje ne perqindje 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në këtë kontratë do të emërtohet pala dhuruese.

DHE

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Petrit Dogani, atesia Fejzi dhe amesi Rronjë, i datelindjes 30.04.1974, lindur dhe banues ne Njesia Administrative Zharrez, Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje Noteres, identifikuar prej leternjoftimit me nr.personal (ID) H40430020D dhe nr. 029459142, ne cilesine e Ortakut themelues te shoqerise "ALB-DRIL" sh.p.k, pronar dhe zotërues i 1 kuote me pjesmarrje ne perqindje 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në këtë kontratë do të emërtohen pala pranuese e dhurimit.

Nepermjet ekstraktit te QKR, te nxjerre nga faqja zyrtare e QKR, verifikoj Gjendjen e Regjistrimit te Shoqerise dhe konstatoj se Shoqeria « ALB-DRIL sh.p.k». eshte shoqeri aktive, nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte ne ndjekje penale, nuk eshte ne sekuestro apo ne forma te tjera kufizimit te zotesise se saj juridike dhe per te vepruar dhe se Petrit Dogani ajo eshte perfaqesuesi i vetem ligjor i saj.

Palet e kesaj kontrate me deshire te lire dhe me vullnet te pavesuar kerkuan nga une noteria redaktimin e kontrates se dhurimit te kuotave te kapitalit themeltare ne shoqerine "alb-dril" sh.p.k, me nr.NUIS L83209401Q si me poshte vijon:

BAZA LIGJORE :

- 1.Kodi Civil i Republikes se Shqiperise dhe ne vecanti te nenit 761, nenit 762 te tij
2. Ligji Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"; dhe ne vecanti neni 73 dhe vijues te tij
- 3.Ligji Nr.9723, date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
4. Ligjit 110 date 28.12.2018 "Per Noterine", ne Republikën e Shqiperise.

NENI 1

OBJEKTI:

Kjo kontrate ka per objekt Dhurimi në masën prej 50% (pesedhje perqind), te kuotes që zotëron pala dhuruese në kapitalin themeltar në shoqërinë "ALB-DRIL" Sh.p.k ku pala dhuruese *Ermal Dogani* eshte zoterues i 1 (nje) kuote ne masen 50% të kuotave te kapitalit themeltar ne vleren prej



50.000 Leke (pesedhjet mije) dhe bëhet pranimi i dhurimit te tyre nga **Z.Petrit Dogani** në masën totale të kuotave që dhurohen, te barabarta ne total me 50 % te kuotave te kapitalit zoterues nga pala dhuruese, ne vleren totale prej 50.000(pesedhjet mije) leke kuotave që dhurohen.

NENI 2 PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare "ALB-DRIL" sh.p.k, me seli ne Fier, Zharez Sheqishte, Rruga "Petraq Poshnjari", Z.K 3361, Pasurisë 114/20-ND, eshte regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi NUIS: L832094010 datë 09.08.2018. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 (njëqind mijë) leke të ndarë në 2 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 50.000 (pesedhjet mije) lek.

Aktualisht kuotat në shoqëri zotërohen si më poshtë vijon:

- Zoti **Ermal Dogani** , zoteron 50% të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 1 kuota në vlerë të përgjithshme 50.000(pesedhjet mije) leke.
- Zoti **Petrit Dogani** zoteron 50 % të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 1 kuota në vlerë të përgjithshme 50.000(pesedhjet mijë) leke.

Me vendimin nr. 1, të datës 19.08.2019 (dymijë e nënëtmëbëdhjetë) të Asamblesë të përgjithëshme të ortakëve të shoqërisë, është vendosur miratimi i dhurimit të kuotave prej 50% që zotëron ortakun Ermal Dogani ne shoqërinë "ALB-DRIL" sh.p.k, ndërsa bëhet pranimi i dhurimit te tyre nga Petrit Dogani, ortakut tjetër i po kesaj shoqëri, në masën totale të kuotave që dhurohen.

Me dhurimin e kuotave nga pala dhuruese, ky veprim sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të ortakut **Ermal Dogani** në masën respektive 50 % të kuotave që zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Alb-Dril" sh.p.k

Dhuruesi eshte plotësisht dakord t'i dhuroje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, të gjitha kuotat prej 50%, që zotëron në kapitalin themeltar në shoqërinë të "Alb-Dril" sh.p.k, pranuesit te dhurimit, ortakut tjere te kesaj shoqërie dhe perkatesisht Petrit Dogani

Nga ana e tij pranuesi i dhurimit Petrit Dogani eshte plotësisht dakord per dhurimin e bere nga ortakut tjetër i shoqërisë "ALB-DRIL" sh.p.k, zoti Ermal Dogani, ne masen 50 % te kuotave te tij.

Duke përfituar pronësinë e kuotave të dhuruara në masën prej 50% te kuotave te shoqërisë, pranuesi i dhurimit Petrit Dogani fiton cilësinë e ortakut te vetem ne shoqërisë "ALB-DRIL" sh.p.k me të gjitha të drejtat e detyrimet që sjell dhurimi i kuotave.

NENI 3 MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesi zoti **Ermal Dogani** , humbet pronësinë mbi kuotat ne masën prej 50% që zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë "ALB-DRIL" sh.p.k, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e dhuruara. Pala dhuruese deklaron se nuk ka patur dhe nuk do të ketë asnjë pretendim për ndonjë të drejtë apo detyrim që rrjedh si rezultat i dhurimit te 50% të kuotave që zotëron në shoqërinë "ALB-DRIL" sh.p.k

3.2 Pala pranuese e dhurimit, zoti **Petrit Dogani**, bëhet pronar në masën 50% të kuotave të dhuruara me të gjitha të drejta dhe detyrimet që mbart pronësia e kuotave, duke fituar njëkohësisht dhe cilësinë e ortakut te vetem ne masen 100% te kuotave ne shoqërine "Alb-Dril" sh.p.k, pasi zoteron 50 % të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 1 kuote në vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjet mijë) leke dhe ne total behet pronar ne masen 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 1 kuote në vlerë të përgjithshme 100.000 Leke (50% +50% =100 %) ne shoqërine "ALB-DRIL" sh.p.k

3.2 Pas realizimit të kësaj kontrate dhurimi, kuotat e shoqërisë shoqërisë "ALB-DRIL sh.p.k do të zotërohen në këtë mënyrë dhe vetem nga:



Zoti Petrit Dogani zotëron 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 1 kuote në vlerë të përgjithshme 100.000 (njqind mijemijë) leke

NENI 4

MODALITETE TE DHURIMIT

4.1. Palet, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, bien dakort qe te gjitha detyrimet ndaj te treteve qe ka shoqeria "ALB-DRIL" sh.p.k nga krijimi i saj e deri ne momentin e kalimit te pronesise nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit, dmth deri sot me date 20.08.2019, jane pergjegjesi e pales pranuese te dhurimit dhe pala dhuruese nuk ka asnje detyrim ndaj te treteve apo ndaj pales pranuese te dhurimit ne lidhje me to.

4.2 Me nenshkrimin, pronesia mbi te gjithe Kuotat e pales dhuruese dhe te drejtat e tjera qe lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, perfshire te drejten e votes dhe te dividendit si dhe te drejtat ne administrimin e Shoqerise i kalon pales pranuese se dhurimit dhe pala dhuruese zhvishet teresisht prej tyre.

NENI 5

DEKLARIME DHE GARANCI

5.1 Pala dhuruese deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem per palen dhuruese. Kuota e dhuruesit, objekt i kesaj Kontrate sipas parashikimeve me siper, dhurohet ne gjendjen ne te cilen eshte dhe me te drejtat qe lidhen me te dhe/ose rrjedhin prej saj.

5.2 Pala pranuese e dhurimit deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem per palen pranuese se dhurimit. Gjithashtu, pala pranuese e dhurimit pranon Kuoten e pales dhuruese objekt i kesaj Kontrate ne gjendjen te cilen eshte dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me te apo te drejtat qe lidhen me te dhe/ose rrjedhin prej saj.

NENI 6

TE NDRYSHME

6.1 Secila prej Paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin, nenshkrimin dhe permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kete Kontrate.

6.2 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne kater origjinale me vlere te njejte secili dhe ky akt perben te gjithe marreveshjen e arritur midis Paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet personalisht nga Palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga Palet ne fjale.

6.3 Kesaj kontrate i bashkelidhet a) vendimi i asamblese se përgjithshme te ortakeve te shoqerise "Alb-Dril" sh.p.k, ekstrakti tregar, mjete identifikuese

NENI 7

LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

7.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.

7.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete Paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier.



Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem Paleve te cilet, pasi me deklaruan se teksti i ketij akti eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time ne 4 (kater) origjinale me vlere te njejte secili, dhe une Noteri vertetoj sa me sipër sipas ligjit ne fuqi.

PALËT E KONTRATES

PALA DHURUESE

ERMAL DOGANI

Emmal Dogani 

PALA PRANUESE E DHURIMIT

PETRIT DOGANI


PETRIT DOGANI 

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilëve, akti ju lexua e lexojnë dhe vet ato, palë shprehen se e kanë kuptuar e pranojnë dhe e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time, pavërejtje ne perputhe me Ligjin 110 date 28.12.2018 "Per Noterine" ne Republiken e Shiperise

**NOTERE
AMARDA B.SHANAJ**

Amarda Shanj





VENDIM
NR 1 Date 19.08.2019
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot, me date 19 Gusht 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u mbledh Asambleja e Ortakeve të shoqërisë tregtare Shoqëria Tregtare "ALB-DRIL" Sh.p.k, me seli në Zharrez, Sheqishte, Rruga "Petraq Poshnjari", Z.K 3361, PASURIA NR.114/20-ND, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër identifikimi dhe NUIS : L83209401Q datë 07.08.2018, e përbërë nga dy ortakët e shoqërisë Petrit Dogani dhe Ermal Dogani.

Me vendim Nr. 1 date 19.08.2019 asambleja e përgjithshme e ortakëve të shoqërisë "ALB-DRIL" Sh.p.k, në mbështetje të Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare", dhe kjo mbledhje asambleje e ortakëve me rend dite :

VENDOSI :

1. Ortaku Ermal Dogan ka vendosur t'i dhurojë kuotat e veta nominale 1 në masen 50 % palet pranues të dhurimit ortakut tjetër të shoqërisë z. Petrit Dogani dhe ortakut tjetër i shoqërisë Petrit Dogani ka vendosur t'i pranojë kuotën e tij nominale në masen 50%, i cili bëhet ortak i vetëm i shoqërisë "ALB-DRIL" Sh.p.k në masen 100 % pjesëmarrja në përqindje, numri i përgjithshëm i kuotave 1.
2. Të dy ortakët duhet të realizojnë Kontratat e dhurimit të kuotave me akt noterial.
3. Autorizohet administratori AdPetrit Dogani të ndjekin të gjitha procedurat në QKB Fier për depozitimin e vendimit nr. 1 date 19.08.2019 të asamblese së ortakëve si regjistrimin e kontratës së dhurimit të kuotave .
Ortakët e shoqërisë "ALB-DRIL" sh.p.k


*Depozitimin e vendimit pranë QKR.

*Depozitimin e kontratës së dhurimit të kuotave pranë QKR

Vendimi i mesipërmerit merret nga ortakët, bazuar në nenet përkatëse të statutit të shoqërisë, si dhe të Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË

PETRIT DOGANI

PETRIT DOGANI


ERMAL DOGANI

ERMAL DOGANI
